

1. Komisioni I Zhvillimit Ekonomik,Financë dhe Tatim Taksave.

Komisioni I zhvillimit ekonomik,financë dhe tatim taksave shqyrton projekt aktet dhe çështjet që lidhen me hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit vendor, menaxhimin e financave publike dhe administrimin e pasurive bashkiake.Komisioni trajton çështjetqë lidhen me planifikimit strategjik të zhvillimit të bashkisë, përdorimin efektiv dhe transparent të burimeve financiare, si dhe garentimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe përgjegjshmërisë financiare të institucioneve vendore.Komisioni ushtron fuksione mbykqyrëse mbi administrimin financiar të bashkisë dhe enteve në varësi të saj, duke dhënë mendime, vlerësime dhe rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, me qëllim forcimin e transparencës, efikasitetit dhe integritetit në menaxhimin e financave publike.

2. Komisioni I Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Turizmit.

Komisioni I kulturës, arsimit, sportit dhe turizmit shqyrton projekt aktet dhe çështjet që lidhen me zhvillimin e jetës kulturore në nivel vendor, mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, historike dhe artistike, si dhe nxitjen e veprimtarisë kulturore dhe artistike në komunitet. Gjithashtu komisioni shqyrton projekt aktet që lidhen me politikat dhe fuksionimin e sistemit arsimor në nivel vendor, zhvillimin e sportit dhe veprimtarive sportive, si dhe organizimin e aktiviteteve të çlodhjes dhe argëtimit për komunitetin.Ai trajton çështje që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe sportive.Komisioni ushtron fuksion këshillimor, duke dhënë mendime, vlerësime dhe rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak, me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e jetëtës sportive e sociale në komunitet.

3. Komisioni Juridik,I Rendit, Mbrojtjes, Emergjencave Civile, Politikave Sociale dhe Barazisë Gjinore.

Komisioni juridik,i rendit, mbrojtjes, emergjencave civile, politikave sociale dhe barazisë gjinore shqyrton projekt aktet dhe çështjet që lidhen me rregulloren, çështjet juridike, administratën, qeverisjen e mirë, proceset zgjedhore dhe fuksionimin e strukturave komunitare,çështjet që lidhen me sigurin publike, parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile, mbrojtjen civile, si dhe masat e rehabilitimit pas fatkeqësive natyrore apo situatave të jashtëzakonshme,çështjet që lidhen me hartimin dhe zbatimin e politikave të mirëqënies sociale, mbështetien dhe përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.Gjithashtu komisioni trajton çështje që lidhen me promovimin e barazisë gjinore, garantimin e mendësive të barabarta, parandalimin dhe luftimin e çdo forme diskriminimi, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel vendor.Komisioni ushtron fuksion këshillimor, duke dhënë mendime, vlerësime dhe rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak.

4. Komisioni për Zhvillim Urban, Ndërtimet, Shërbimet dhe Srehimin.

Komisioni për zhvillim urban, ndërtimet, shërbimet dhe srehimin shqyrton projekt aktet dhe çështjet që lidhen me planikimin dhe zhvillimin e territorit, infrastrukturën publike, çështjet që lidhen me ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve publike, rrjete shërbyese, si dhe politikatat e strehimit, duke dhënë mendime dhe rekomandime për Këshillin Bashkiak.

5. Komisioni për Zhvillimnt Bujqësor, Blektoral dhe Agroturizmit.

Komisioni për zhvillimit bujqësore, blektorale dhe agroturizmit shqyrton projekt aktet dhe çështjet që lidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe blektorisë, administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve, menaxhimin e burimeve ujore si dhe politikatat për mbrojtjen e mjedisit, menaxhinin e mbetjeve, duke dhënë mendime dhe rekomandime për këshillin Bashkiak.